

SPECIFIKIMIET TEKNIKE

VAJ IZOLUES MINERAL I RI, I PAPERDORUR, PER TRASFORMATORE DHE CELESAT E N/STACIONEVE

1. Pershkrimi teknik.

Vaj i transformatorit perftohet nga përpunimi i thellë i naftës. Ai ka qendrushmeri të lartë ndaj oksidimit, është izolues i nivelit të lartë dhe përdoret në pajisjet që punojnë dhe operojnë në temperaturë të lartë dhe që kërkojnë qendrushmeri të madhe ndaj oksidimit. Vaj transformatori ka përmbajtje të ulët squfuri, pike te larte flakerimi, aciditetin e ulët që ndikon në jetëgjatesinë e pajisjeve ku do te përdoret. Viskoziteti i ulët lejon mirë dhe shpejt transmetimin e nxehtësisë.

E rëndësishme është qe përmbajtja e PCB gjate testimeve duhet të jete i pakapshem nga aparatet .

Standarti i vajit izolues mineral të papërdorur është sipas IEC 60 296.

2. Përdorimi

Vaj i transformatorit, përdoret si izolues dhe material ftohes në transformatorët e fuqisë me vaj, celesa me vaj , etj

3. Kerkesat

Vaj mineral izolues i papërdorur në përputhje me kete standart duhet të plotësojë vlerat perkatese te specifikuara në tabelen me poshte. Këto vlera duhet te kontrollohen dhe plotesohen vetëm për vaj izolues mineral te papërdorur, kur dorezohet dhe para futjes së tij në aparate.

Vaji duhet te kete markim CE

4. Menyrat e testimit

Pamja vizuale (paraqitja)

Paraqitja do të vlerësohen duke shqyrtuar një mostër perkatese te vajit me një trashësi prej rreth 10 cm në dritë transparente dhe në temperaturën e ambientit.

Dendësia

Per kete mund te përdoret cdo metodë e njohur Testimi. Por metoda që do të përdoret në rastet e kontestimit do të jetë sipas standartit ISO 3675.

Densiteti do te matet ne temp. 20°C sipas formules :

$$P_{20} = P_t [1 + X(t - 20)]$$

Ku :	P_{20}	- densiteti ne 20°C
	t	- temperature ne grade celcius
	P_t	- densiteti i matur në temperaturën t
	X	- Faktori korrektues = $65 \cdot 10^{-5}$ (vlere e perafert)

Për saktësinë më të madhe, faktor korrigjimi duhet të përdoren nga lista e rekomanduar ne ISO R/91

Tabela e vlerave te kerkuara

Karakteristikat	Njesia	St. Testit	Vlerat e kerkuara
1. Fizike			
Ngjyra			<0.5
Appearanca		IEC 60296	E qarte dhe e ndriteshme

Specifikimet teknike – Vaj izolues mineral i paperdorur

Viskoziteti ne 40 °C	mm ² /S	ISO 3104	9.5
Viskoziteti ne -30 °C	mm ² /S	ISO 3104	≤900
Pika e ngrirjes	°C	ISO 3016	-45
Densiteti ne 20°C	kg/dm ³	ISO 12185	0.875
2. KIMIKE			
Aciditeti	mg KOH/g	IEC 62021	<0.01
Squfur koroziv		IEC 62535	jo
Permbajtja e ujit	mg/kg	IEC 60814	<15
Antioksidant Wt	%	IEC 60666	<0.4
Permbajtja aromatike	%	IEC 60590	10
Permbajtja e sqfurit	%	ISO 14596	0.1
3. ELEKTRIKE			
Tensioni I cpimit Para trajtimit	kV	IEC 60156	≥45
Faktori dielektrik I shperndarjes(DDF) tanδ ne 90 °C		IEC 60247	<0.001
Tensioni shtrese	mN /m	IEC 6295	45
Tendenca e gazit	µl/min		+10
4. STABILITETI I OKSIDIMIT			
Ne 120°C, 500h		IEC 61125 C	IEC 61125 C
Aciditeti total	mgKOH/g		<0.3
Llumi(papastertit)	W _t %		<0.02
5. Shendet, siguria dhe mjedisi			
Permbajtja totale e PCB	mg/Kg	IEC 61619	E pa diktueshme
Pika e flakerimit, PM	°C	ISO 2719	145
Komponimet e nxjereshme DMSO	W _t %	IP 346	<3

5. Kërkesa per ruajtjen, trajtimin dhe transportin

Vaji I trasformatorit furnizohet ne fuci 180-200kg, te cilat jane te vulosura me vulen e prodhuesit. Gjate magazinimit dhe transportit duhet pasur kujdes qe te mbahet larg nga flaket, ndezesave ose siperfaqeve te nxehta. Produkti ruhet ne ambiente te pastra dhe ne ene te thata dhe te vulosura hermetikisht kur nuk eshte ne perdorim. Fucite duhet te kene etiketat perkatese, ku është emri dhe adresa e prodhuesit, data e prodhimit, sasia, numri I kontratës.

6. Testet

Furnizuesi duhet te siguroje seri te plote te testeve te fabrikes, sic tregohet dhe pershkruhet me siper.

7. Testet pas dorezimit

Pasi malli te jete dorezuar, Blerësi ka të drejtat për të kryer teste në vend para pranimit të mallrave. Kostoja e këtyre testeve do të paguhet nga Shitësi. Nëse rezultati i testeve të kryera tejkalon shifrat e kërkuara, siç tregohet në tabelën më sipër, Blerësi ka të drejtë të refuzojë mallin.